



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2024:034447

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05420491

**C.nr.732/2024**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V.**, gjyqtari Raif Fazliu, me bashkëpunëtoren profesionale Dardana Behluli, në çështjen kontestimore të paditëses M.B. nga V., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson X.H., avokat në V., kundër të paditurës Komuna e V.-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi në bazë të inflacionit, vlera e kontestit 757.79 €, jashtë seancës gjyqësore, me datë 07.03.2024, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I. Miratohet** pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.B. nga V., **detyrohet** e paditura Komuna e V.-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses, në emër të pagesës shtesë në bazë të përqindjes së inflacionit, t'ia paguajë: për periudhën janar-dhjetor 2021, shumën 171.76 € dhe për periudhën janar-nëntor 2022, shumën 537.19 €, në shumë të përgjithshme 708.95 €, me kamatë ligjore 8 % nga dita e ushtrimit të padisë me datë 29.01.2024 e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

**II. Refuzohet** pjesërisht pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses në emër të inflacionit, e kërkuar për muajin dhjetor të V.t 2022, në shumën 48.84 €.

**III. Detyrohet** e paditura që paditëses t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë 125 €, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

### **A r s y e t i m**

E autorizuar e paditëses, me datë 29.01.2024, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi i inflacionit në pagë, vlera e kontestit 757.79 €.

Në padi, paditësja ka theksuar se është në marrëdhënie pune tek e paditura, në ShFMU "28 Nëntori", në fshatin V., Komuna V. dhe nga gjykata ka kërkuar që e paditura, në emër të pagesës shtesë në bazë të përqindjes së inflacionit, për periudhën janar-dhjetor 2021, t'ia paguajë shumën 171.76 € dhe për periudhën janar-dhjetor 2022, t'ia paguajë shumën 586.03 €, në shumën e përgjithshme 757.79 €. Të drejtën e saj e ka bazuar në nenin 35, paragrafi 10 të

Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK) të V.t 14.04.2017 dhe 22.01.2021. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë shumën 104 € për përpilimin e padisë dhe 21 € për taksën gjyqësore për padi.

E paditura, përmes përgjigjjes në padi, e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, me pretendimin se kërkesa nuk është e bazuar në ligj, pasi që obligimet e parapara në KKAK duhet të paguhen nga niveli qendror, Ministrinë përkatëse dhe anën tjetër, ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit e kanë shkëputur këtë kontratë andaj rrjedhimisht edhe nuk mund të prodhojë obligim ligjor për të paditurën. Gjithashtu, e paditura është thirrur edhe në parashkrim të kërkesës së paditëses ashtu që, gjykatës i ka propozuar të refuzojë kërkesëpadinë e paditëses të pa bazuar në ligj. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Pas pranimit të përgjigjjes në padi, gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës gjyqësore, duke u mbështetur në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK), me të cilin përcaktohet se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigjja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, ka ardhur në përfundim se të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara në këtë nen janë plotësuar sepse, gjendja faktike nuk është kontestuese e po ashtu nuk ekzistojnë pengesa të tjera që pa caktuar seancë gjyqësore të pranohet si e themeltë kërkesëpadija e paditëses si dhe nenin 399.1 që përcakton se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigjja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pa themeltë kërkesëpadija”.

Gjykata ka gjetur se ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësja është e punësuar tek e paditura, se pagën bazë e ka 421 € ndërsa, se shkalla e inflacionit për V.n 2021 është 3.4 % dhe për V.n 2022 është 11.6 %, fakt i provuar nga llogaritja e shkallës mesatare të inflacionit nga Enti i Statistikave të Kosovës. Duke u mbështetur në nenin 329.1 të LPK-së, gjykata, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror, këtu vet e paditura dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata, duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk i ka mohuar faktet vendimtare e as gjendjen faktike por vetëm bazën e kërkesëpadiës, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor, pasi themelësia e kërkesëpadiës së paditëses, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazën ligjore e ka në dispozitat e nenit 55, par. 1 të Ligjit të Punës, i cili ka përcaktuar se: “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenin 90, par. 5 i cili ka përcaktuar se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive” dhe KKAK të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, nenin 35, par. 10 sipas të cilit është përcaktuar: “Për çdo vit të përcillet shkalla

Numri i lëndës: 2024:034447  
Datë: 07.03.2024  
Numri i dokumentit: 05420491

e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”.

Sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 40/2023, të datës 27.02.2023 dhe nr. 214/2023, të datës 05.10.2023, dispozitat e KKAK-së për V.n 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017-21.01.2021 dhe për V.n 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021-21.11.2022.

Paditësja, detyrimin për kompensim nga e paditura e ka kërkuar për periudhën janar-dhjetor 2021 dhe janar-dhjetor 2022 mirëpo, pasi e paditura është thirrur në parashkrim të kërkesës së paditësit, gjykata vlerësoi afatshmërinë e kërkesës së tij dhe gjeti se padia është ushtruar me datë 29.01.2024, qka do të thotë që padia është ushtruar brenda afatit të përcaktuar kohor prej 3 vitesh mirëpo, duke qenë se KKAK, në fuqi nga data 22.01.2021, për palët nënshkruese të saj nuk krijon të drejta dhe detyrime pas datës 21.11.2022 sepse po në këtë datë MASHTI ka deklaruar se e shkëputë kontratën, gjykata e refuzoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses për muajin dhjetor 2022, pasi kërkesëpadia e saj për këtë periudhë kohore nuk ka bazë ligjore.

Kundërshtimet e të paditurës janë gjetur të pa bazuara sepse palët kontraktuese të KKAK-së, (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), në nenin 2, par. 1.2., kanë përcaktuar: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës” andaj, gjykata aprovoi të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Sa i përket pretendimeve se nuk ka pasur inflacion të theksuar, sipas nenit 35, par. 10 të kontratës është përcaktuar se shkalla e inflacionit duhet të përcillet për çdo vit dhe përqindja e saj të futet në pagë dhe anën tjetër, nga Enti i Statistikave të Republikës së Kosovës është përcaktuar se kjo përqindje për V.n 2020 është 0.2 %, për V.n 2021 është 3.4 % dhe për V.n 2022 është 11.6 %.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u mbështetur në nenin 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, pasi e paditura e ka humbur kontestin gjyqësor dhe për këtë arsye u detyrua t’ia paguajë paditësit shpenzimet për taksë në shumën 21 € dhe për përpilimin e padisë shumën prej 104 €.

Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 142, 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V.

C.nr.732/2024, Datë 07.03.2024

Gj y q t a r i,  
Raif Fazliu

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2024:034447  
Datë: 07.03.2024  
Numri i dokumentit: 05420491